



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.211/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Hasan Shala anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore, Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovën, dega në Mitrovicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), subjektit politik NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 550,00 (pesëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 13.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AKR, me të cilën pretendon se subjekti politik NISMA ka vendosur Reklamat e subjektit të tyre, në vend publik, pa marrë leje paraprake nga organet kompetente Komunale. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se janë shkelur Rregullat Zgjedhore.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka ofruar fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të datës 14.10.2017, subjekti politik NISMA, ka theksuar se pas marrjes së ankesës ka marrë veprimet konkrete përmirësuese, duke kontaktuar shtabin zgjedhor të degës në Mitrovicë, dhe të njëjtit i kanë detyruar që menjëherë ta largojnë reklamën mobile me foto e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur disa fotografi.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se reklama mobile me fotot e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik NISMA, janë vendosur në vend publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik NISMA, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik NISMA, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti, reklama mobile me fotot e kandidatëve të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar janë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr reklamën mobile nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), 117 par. 2 dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

ZL.Anr. 211/2017 më datën 16.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
**Adnan Konushevc**

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.***